



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:215307
Datë: 30.08.2024
Numri i dokumentit: 06107505

C.nr.1515/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË/ Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, gjyqtarja Vlerona Maliqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve G. M., S. A. dhe B. M., të gjithë nga M., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Hidajete Mazhiqi, avokate nga Mitrovica, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës-Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensim i pagave shtesë në emër të licencimit, duke vendosur lidhur me lejueshmërinë e marrëveshjes së lidhur në mes të palëve ndërgjyqëse në procedurën e ndërmjetësimit, jashtë seancës, më datë 29.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET MARRËVESHJA** për zgjidhje të ndërmjetësuar, me numër të lëndës Nd.641/2023, e arritur në Qendrën për Ndërmjetësim në Mitrovicë me datë 12.04.2024, në mes të paditësve G. M., S. A. dhe B. M., të gjithë nga M., dhe të paditurës Komuna e Mitrovicës-Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensim i pagave shtesë në emër të licencimit.
- II.** Marrëveshja e aprovuar e ka fuqinë e titullit ekzekutiv-përmbarues.

A r s y e t i m

Paditësit G. M., S. A. dhe B. M., të gjithë nga M., përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë kanë parashtruar padi me datë 27.09.2021, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës-Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensim i pagave shtesë në emër të licencimit.

Gjykata me vendimin e datës 22.12.2023, pas shqyrtimit paraprak të lëndës, pasi ka vlerësuar përshtatshmërinë e çështjes për t'u referuar në procedurë të ndërmjetësimit, konform dispozitës së nenit 8 par.1 të Ligjit Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim dhe Rregullores Nr.04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave, ka inicuar procedurën e ndërmjetësimit, në këtë çështje juridike kontestimore.

Zyra për Ndërmjetësim pranë Gjykatën Themelore në Mitrovicë, më datë 27.08.2024, e ka njoftuar gjykatën se palët ndërgjyqëse, kanë arritur marrëveshje për këtë çështje juridike kontestimore, duke i'a dorëzuar gjykatës marrëveshjen e lidhur në mes tyre.

Gjykata duke ju referuar të cekurave më lart e duke u mbështetur në dispozitën e nenit 411 dhe 412 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenin 15 par.1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, ka ardhur në përfundim se marrëveshja e arritur në procedurë të ndërmjetësimit duhet të aprovohet, pasi plotëson të gjitha kushtet ligjore dhe e njëjta është dokument përmbarimor, pra paraqet titull përmbarues.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.1515/2021 më datë 29.08.2024

G j y q t a r j a

Vlerona Maliqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.